



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:231254
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714416

E.nr.755/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: I.S., Sh.H., A.H. dhe A.S., të cilët i përfaqëson av Islam Gashi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shtesës për shpenzime të udhëtimit, ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 22.05.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.755/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.755/23, të datës 17.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shtesës për shpenzime të udhëtimit, ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:231254, të datës 06.12.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 22.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,819.60 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.755/23, më datë 21.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi